

VENDIM
Nr. 703, datë 16.8.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË
VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si më poshtë vijon:

a) Në programin 08230 “Për artin dhe kulturën”, në zërin “Shpenzime kapitale”, të pakësohet fondi 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

b) Në programin 08220 “Për trashëgiminë kulturore” në zërin “Shpenzime kapitale”, të shtohet fondi 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha